



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Kom.Dh.Shk.II.nr.544/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit F... shpk nga Prishtina kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2720/18 të datës 22.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit F... shpk nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2720/18 të datës 22.01.2021, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2720/18 të datës 22.01.2021, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit F... shpk nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë-Departamenti i Ankesave nr.398/2018 dt.24.09.2018.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, Apolona Sylja avokate nga Prishtina për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të priset aktgjykimi A.nr.2720/18 të datës 22.01.2021, ashtu që lënda ti kthehet gjykatës së njëjtë në rishqyrtim dhe rivendosje. E kundërshtojmë vendimin dhe qëndrimin e ATK-së-së, sa i përket rezultatit të kontrollit të bërë, për shkak se vendimi, përveç që është një përshtatje e situatës në bazë të bindjes personale dhe pa prova, është gjithashtu edhe në kundërshtim me Ligjin 02/L-123 për Shoqëri Tregtare, dispozitat ligjore lidhur me rregullat mbi tatimin e deponimeve të personave fizik dhe ata juridik. Duke marrë parasysh se z.H.A. është një person fizik i cili vetëm ka qenë aksionar në personin juridik

si më lartë, nuk është e ligjshme që deponimet e tij në xhirollogarinë personale të tatimohen si vlerë e shtuar e personit juridik në të cilin dikur ka qenë aksionar, duke u mbështetur vetëm në shkaqet e cekura si në vendimin 398/18. Si rrjedhojë e kësaj paditësi nuk ka asnjë obligim ligjor që të paguaj tatim për të ardhurat deponimet e personave tjerë fizik, përderisa ai person nuk ka qenë i vetmi pronar i subjektit F... shpk. Andaj konsiderojmë se gjykata e shkallës së parë është dashtë të merr parasysh faktin se z. H.A. , para se gjithave është person fizik dhe ka edhe biznese tjera, si dhe përveç obligimit që ka tatimpaguesi të vërtetoj mjetet e ardhura, gjithashtu e paditura ka për obligim të vërtetoj dhe të ketë bazë të fortë kur i vie në barrë tatimi për të hyrat.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.398/2018 të datës 24.09.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e tatimpaguesit F... shpk nga Prishtina, dhe ka konfirmuar si të bazuara Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë dhe ndëshkimet e caktuara me kontroll. Paditësi ndaj këtij vendimi të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi në gjykatë, me të cilën ka inicuar konflikt administrativ respektivisht ka kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit nr.398/2018 të datës 24.09.2018 të paditurës ATK-së, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm, duke i propozuar gjykatës ta anuloj vendimin e kundërshtuar me padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit përfundimtar në procedurën administrative të nxjerr nga e paditura Administrata Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 22.01.2021, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se e paditura ka vepruar drejtë kur paditësin e ka ngarkuar me qarkullim dhe tatim shesë për deponimet bankare të aksionarit dhe drejtorit, për arsye se paditësi në asnjë fazë të procedurës administrative nuk ka arrit që me prova dhe dëshmi konkrete të vërtetoj pretendimin se mjetet e deponuara e kanë burimin nga ndonjë burim i pa tatueshëm, pra janë mjetet të cilat nuk i nënshtrohen detyrimeve tatimore. Vendimin e vet gjykata e shkallës së parë e mbështet në legjislacionin tatimor nenin 19.2 të Ligjit 03/L-222 dhe nenit 30 par.1 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 për zbatimin e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe Ligjin 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave procedurale apo ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Kolegji konstaton, se gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LPK-së. Ndërsa tek pala e paditur gjatë procedimit administrativ, Kolegji nuk ka gjetur se ekzistojnë shkelje të dispozitave procedurale të cilat do të kishin ndikim në marrjen e vendimit kontestues nr.398/2018 dt.24.09.2018 apo Raportit të Kontrollit nr.dosjes ..... dt.16.07.2018.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se rezultati i kontrollit tatimor të bërë, është një përshtatje e situatës në bazë të bindjes personale dhe pa prova, dhe në kundërshtim me Ligjin 02/L-123 për Shoqëri Tregtare, këto pretendime ankimore, Kolegji, i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, si dhe janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Ngase e paditura respektivisht kontrolli tatimor ka prioritet zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi, e që në këtë rast ka autorizime ligjore që në vështirësi të nenit 19 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të bëj vlerësim në bazë të provave dhe informatave që ka në disponim. Kolegji vlerësoi se informatat nga trajtimi i deponimeve bankare mbi të cilat ka rezultuar qarkullimi dhe tatimi shtesë ndaj palës paditëse, janë veprime procedurale të drejta të cilat në këtë rast gjejnë mbështetje ligjore nga neni 30 i Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit 03/L-222. Prandaj Kolegji vlerësoi se nuk mund të anashkalohet në këtë rast legjislacioni tatimor, siq pretendon pala ankimore në ankesë, dhe të vlerësohen të drejtat dhe obligimet e përmbushjes së detyrimit tatimor, të paditësit F... shpk-Prishtinë, sipas Ligjit 02/L-123 për Shoqëri Tregtare. Kolegji vlerëson se legjislacioni tatimor respektivisht neni 16 i Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ka paraparë obligimet e përfaqësuesve dhe menagjerëve të subjekteve juridik, përmbushjen e obligimeve tatimore, pra nuk i liron ata nga obligimet tatimore që kanë në cilësinë e ortakëve, personave fizik apo menaxherë.

Andaj, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është refuzuar kërkesë padia e paditësit, për arsye se e paditura ka aplikuar drejt legjislacionin tatimor në këtë rast nenin 30 pika 3 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 dhe nenin 19.3 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, kur e ka ngarkuar paditësin me qarkullim dhe tatim shtesë, në bazë të mjeteve të deponuara në llogarinë bankare pa dëshmuar burim të tatuueshëm të këtyre mjeteve financiare. Kolegji, vlerësoi se paditësi ka pasur obligim ligjor të paraqes para paditurës dhe gjykatës së shkallës së parë, burimin e deponimeve bankare në bazë të cilave është ngarkuar me qarkullim dhe tatim shtesë, e në anën tjetër gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar me të drejt gjendjen faktike, se paditësi nuk ka paraqit dokumentacion apo çfarëdo burimi për të dëshmuar prejardhjen e mjeteve financiare.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim

në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenit 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.544/22 datë 17.11.2022

Kryetar i kolegjit,  
Krenar Berisha